



Komuna e Gjakovës



Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Bashkëfinancimi

në mes të

Komunës së Gjakovës

dhe

Caritas Kosova

Me qëllim të vendosjes së bashkëpunimit në mes të Komunës së Gjakovës dhe Caritasit të Kosovës, palët nënshkruese pajtohen të lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi për Funksionimin e Qendrës Sociale-Edukative 'Caritas Kosova' në lagjen Ali Ibra në Gjakovë. Kjo marrëveshje vjen pas bashkëpunimit shumëvjeçar në misionin e përbashkët të Palëve në përfshirjen sociale të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Neni 1 - Palët

Palët e kësaj Marrëveshje janë:

- Komuna e Gjakovës - prezantuar nga, **z. Ardian Gjini - Kryetar i Komunës**, dhe
- Caritas Kosova - prezantuar nga **Don Viktor Sopi - Drejtor Gjeneral**

Neni 2 - Qëllimi

Kjo marrëveshje lidhet me qëllim të financimit të projektit të përbashkët me titull:

"Funksionimi i Qendrës Sociale-Edukative "Caritas Kosova" në Ali Ibra, Gjakovë"

Neni 3 - Fushëveprimi

Kjo marrëveshje parasheh funksionimin e Qendrës dhe aktivitetet kryesore ndërlidhen me:

- Edukimin e fëmijëve parashkollor nga mosha 3-6 vjeç
- Programin 'ndihmë në detyrat e shtëpisë'
- Përkujdesi për shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës
- Ofrimin e shërbimeve shëndetësore në kuadër të projektit të Caritas Kosova të quajtur Home Care
- Asistencë sociale për familjet në nevojë të komuniteteve Rom, Ashkanli dhe Egjiptian
- Aktivitete psiko-sociale, kulturore dhe sportive
- Çështje të tjera të karakterit social dhe humanitar

Neni 4 - Kohëzgjatja

Periudha kohore e implementimit të marrëveshjes: 1 Janar 2020 – 31 Dhjetor 2020

Neni 5 - Obligimet e palëve

Me qëllim të zbatimit të marrëveshjes Caritas Kosova merr përgjegjësi këto obligime:

1.1 Caritas Kosova është pala përgjegjëse për zbatimin e projektit ku do të menaxhoj dhe përcjellë nga afër tërë veprimtarinë e stafit profesional të punësuar në këtë projekt, në mënyrë që të veprojnë në bazë të planit të veprimit dhe orareve të vendosura nga Palët.

1.2 Caritas Kosova, do të bashkëpunojë me institucionet relevante të Komunës së Gjakovës, respektivisht me Drejtorinë e Arsimit, me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me Zyrën për Kthim dhe Komunitete, etj. Caritas Kosova do të përgatis raporte në baza vjetore për të prezantuar zhvillimin e projektit, rezultatet e arritura si dhe raportet finaciare. Po ashtu Caritas Kosova do të kompletoj lëndët, përpiloj faturat dhe dorëzoj në drejtoritë përkatëse sipas udhëzimeve të personit zyrtar të Komunës. Të njëjtat do të ju dërgohen institucioneve bashkëpunuese të sipër përmendura.

1.3 Caritas Kosova do të ofroj trjanime për stafin profesional në mënyrë që puna të jetë profesionale dhe konform ligjeve dhe normave të aplikueshme në nivel të vendit.

Me qëllim të zbatimit të marrëveshjes Komuna e Gjakovës merr përgjegjësi këto obligime:

2.1 Të monitoroj zbatimin e projektit.

2.2 Të kryej obligimet finaciare sipas Nenit 6 të kësaj marrëveshje.

2.3 Të kryej obligimet e komunalive (rrymë, ujë, mbeturina).

Neni 6 - Financimi

Komuna e Gjakovës dhe Caritas Kosova do të bashkë financojnë realizimin e këtij projekti me kosto të përgjithshme prej **42,880.80 €**.

Komuna e Gjakovës do të participoj me shumën **22,990.80 €**

Caritas Kosova do të participoj me shumën prej **19,890.00 €**

Vlera e participimit nga Komuna e Gjakovës do të transferohet në llogarinë bankare të Caritas Kosova në këste sipas mundësive finaciare të Drejtorisë së Arsimit. Këstet do të ndahen në atë mënyrë që të mundësojnë një zbatim të mirë të kësaj Marrëveshje.

Të dhënat e llogarisë bankare:

PROCREDIT BANK

KOS CATHOLIC CHURCH CARITAS NGO

Nr: 1170 0170 0100 0163

Neni 7 - Anekset

Pjesë e bashkëngjitur e kësaj Marrëveshje është plani buxhetor i këtij projekti.

Neni 8 - Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje pajtohen që me mirëkuptim, konsultim dhe negociim të zgjidhin të gjitha çështjet kontestuese që mund të lindin gjatë zbatimit të Marrëveshjes. Në të kundërtën kompetente është Gjykata Themelore në Gjakovë.

Neni 9 - Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi hyn në fuqi me datën 01.01.2020 dhe është e përpiluar në 4 ekzemplar të njejt, nga dy për secilën palë.

Data e nënshkrimit: 31.01.2020

Palët nënshkruese

Ardian Gjini
Kryetar
Komuna Gjakovë



Don Viktor Sopi
Drejtor Gjeneral
Caritas Kosova



Titulli i Projektit:		Funksionalizimi i Qendres ne Ali Ibra-Gjakovë					
Periudha:		Janar - Dhjetor 2020					
Poz.	Pershkrimi	EUR		EUR		EUR	
Nr.		Totali i shpenzimeve		Kontributi i Caritas Kosova		Kontributi Komunes se Gjakoves	
A	Burimet Njerezore (menaxhmenti)	15,000.00 €		3,600.00 €		11,400.00 €	
1	Koordinatori i projektit Zyra Qendrore (15%)	12	150.00	1,800.00 €		1,800.00 €	
2	Kordinatori i Qendres (100%)	12	450.00	5,400.00 €		5,400.00 €	
3	Zyrtari financiar Zyra Qendrore (15%)	12	150.00	1,800.00 €		1,800.00 €	
4	Mirembajtëse	12	220.00	2,640.00 €		2,640.00 €	
5	Roja	12	280.00	3,360.00 €		3,360.00 €	
B	Komponentet e programit	21,020.00 €		11,930.00 €		9,090.00 €	
6	Edukator-Fasilitues (2 persona) Klaset 1 - 9	24	360.00	8,640.00 €		8,640.00 €	
8	Material didaktik	1	400.00	400.00 €		200.00 €	
9	Aktivitetet sociale dhe kulturore	1	300.00	300.00 €		150.00 €	
10	Home care sherbimet (2 infermiere)	24	370.00	8,880.00 €		8,880.00 €	
11	Medikamente	12	50.00	600.00 €		600.00 €	
12	Materiale promovuese	1	200.00	200.00 €		100.00 €	
13	Asistence per familjet e verfera (pako ushqimore, higjienike, veshembathje, mobilje)	1	2,000.00	2,000.00 €		2,000.00 €	
C	Shpenzimet operative	6,020.00 €		4,360.00 €		1,660.00 €	
14	Transporti, derivate	12	50.00	600.00 €		400.00 €	
15	Vetura e Home Care	1	3,500.00	3,500.00 €		3,500.00 €	
16	Mirembajtje e veturave, sigurim dhe regjistrim	1	500.00	500.00 €		250.00 €	
17	Material per zyre	12	15.00	180.00 €		90.00 €	
18	Telefon, internet	12	20.00	240.00 €		120.00 €	
19	Ngrohja (pelet)	1	1,000.00	1,000.00 €		1,000.00 €	
	SUBTOTAL	42,040.00 €		19,890.00 €		22,150.00 €	
20	Shpenzimet administrative 2%			840.80 €		840.80 €	
	TOTALI	42,880.80 €		19,890.00 €		22,990.80 €	
						Komente	